



K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 16276 Prot

Lezhë 18.08.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. — Datë 18/08/2026

“PËR EMËRTIMIN E RRUGËS NR.59 03170053 ME EMRIN “ZEF PËRDEDA” NË FSHATIN TRESH NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, me kërkesë të komunitetit të zonës, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë vendosi:

V E N D O S I :

1. Emërtimin e rrugës nr.59 03170053 me emrin “Zef Përdeda” në fshatin Tresh, Njësia Administrative Zejmen.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE
MJEDISIT

Nr. 16276/Prot,

Lezhë, me 18.08.2026

**RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN
“PËR EMËRTIMIN E RRUGËS NR. 59 03170053 ME EMRIN “ZEF PËRDEDA” NË
FSHATIN TRESH NJËSIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN”**

Ky projekt-vendim paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Lezhë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe kërkesës me nr 141/1 Prot. datë 27.02.2026 nga banorët e fshatit Tresh, Njësia Administrative Zejmen të cilët e frekuentojnë këtë rrugë.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, banorët e fshatit Tresh, Njësia Administrative Zejmen kanë propozuar që segmenti rrugor nr. **59 03170053** i lagjes “Bonifikim” të emërtohet me emrin “**Zef Përdeda**”, në shenjë vlerësimi dhe respekti për figurën e tij, duke e konsideruar atë si një person me kontribut në luftën për liri dhe pavarësi të vendit. Sipas deklarimeve dhe vlerësimeve të komunitetit lokal, kjo figurë gëzon respekt dhe vlerësim të veçantë nga banorët e zonës për rolin dhe kontributin e dhënë në periudha të rëndësishme historike.

Propozimi i paraqitur nga komuniteti ka karakter përkujtimor të historisë së zonës, si dhe promovimin e vlerave qytetare, kulturore të zones. Nëpërmjet këtij emërtimi synohet gjithashtu që të vlerësohen figurat që kanë kontribuar në historinë e komunitetit lokal, duke përcjellë këto vlera edhe tek brezat e rinj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e kryera nga strukturat përkatëse të administratës së Bashkisë Lezhë, si dhe nga informacioni i marrë nga Autoriteti për informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit rezulton se emërtimi i propozuar është në përputhje me kriteret dhe praktikat administrative për emërtimin e rrugëve.

KRYETARI
Pjerin NDREU

